



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës:	2023:106853
Datë:	12.05.2023
Numri i dokumentit:	04276200
Dosja fizike:	C-IV-21-0219

Xh H nga Kamanica
I përfaqësuar sipas autorizimit nga B I, avokat nga Prishtina.

Paditësi

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

E paditura

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 12.05.2023, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Miratohet pjesërisht si bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh H dhe NDRYSHOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI045-0992, dt. 13.03.2015, ashtu që:

Detyrohet e paditura Agjencia Kosovare e Privatizimit, që paditësit t’ia paguaj shumën prej 6,045.74 €, në emër të kompensimit të pagave të mbetura të papaguara përgjatë periudhës 12.02.1991-01.07.1999, si dhe shumën prej 645.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 6,690.74 €, e cila shumë duhet të shpërndahet tek paditësi, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

II. Refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh H në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara, respektivisht mbi shumën e aprovuar me këtë aktgjykim prej 6,045.74 €, e deri në shumën e kërkuar prej 55,405.00 €.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën prej 634.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

Rrethanat procedurale të çështjes

Me datën 11.08.2017, paditësi ka paraqitur padi pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit (AL), me shenjën GJI045-0992, dt.13.03.2015.

Pala paditëse në padi ndër të tjera ka theksuar: Ka qene punëtor i N.SH “XIQ Karaçeva” (Ndërmarrja) dhe me datën 12.02.1991, është përjashtuar nga puna në mënyrë të kundërligjshme nga masat e dhunshme të instaluara në Ndërmarrje. Pas përjashtimit nga puna ka ndjekur procedurat e duhura ligjore duke e kundërshtuar vendimin për largim nga puna. Pranë Gjykatës Komunale në Kamenicë ka parashtruar padi dhe se e njëjta gjykatë me aktgjykimin me numër C.nr.102/2003, e ka aprovuar si të bazuar padinë e parashtruar ku e ka anuluar vendimin e drejtorit të ndërmarrjes te datës 12.02.1991 dhe e ka detyruar palën e paditur që paditësin ta kthej në vendin e punës me të gjitha te drejtat nga marrëdhënia e punës. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 07.12.2003. Pastaj, me datën 01.02.2005, ka parashtruar padi pranë Dhomës së Posaçme te Gjykatës Supreme dhe se kjo gjykatë me datën 07.04.2005, ka sjellë aktvendim me të cilin padinë e parashtruar e ka referuar pranë Gjykatës Komunale në Kamenicë. Me datën 10.10.2005 Gjykata Komunale në Kamenicë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.83/2005, me të cilin kërkesëpadinë e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Gjykata e Qarkut në Gjilan duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga pala paditëse e ka prishur aktgjykimin me numër C.nr.83/2005, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Me datën 12.04.2007, Gjykata Komunale në Kamenicë ka nxjerrë aktgjykim me të cilin kërkesëpadinë e parashtruar e ka miratuar pjesërisht. Kundër atij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan e cila me aktvendimin me numër AC.nr.279/07, e ka aprovuar ankesën e parashtruar nga pala paditëse dhe lëndën e ka kthyer përsëri në rigjykim. Me datën 10.02.2009, Gjykata Komunale në Kamenicë ka nxjerrë aktgjykimin me numër C.nr.105/07, me të cilin kërkesëpadinë e parashtruar e ka aprovuar pjesërisht dhe e ka detyruar NSH-në që palës paditëse t’ia kompensoj te ardhurat personale në shumën prej 6,045.74 €, për periudhën 1991-1999, ndërsa në paragrafin II të dispozitivit kërkesëpadinë për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën 1999-2004, e ka refuzuar. Gjykata e Qarkut në Gjilan duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga pala paditëse me aktvendimin me numër AC.nr.183/09, aktgjykimin me numër C.nr.105/07, e ka prishur në pikën 2 dhe 3 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Më tutje, në padi është theksuar se me aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Kamenicë, është konstatuar kundërligjshmëria e largimit nga puna. Ndërsa lidhur me padinë e parashtruar për kompensimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës, ende nuk është përfunduar gjykimi. Nga raporti i ekspertizës i cili është dorëzuar në gjykatë ka rezultuar se shuma e tërësishme e pagave për periudhën 1991-2004, është 55,405.00 €. Pranë AL-së ka parashtruar kërkesë kreditore për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën 1991-2004, në shumën prej 55,405.00 €, mirëpo AL këtë kërkesë kreditore e ka refuzuar si të pa bazuar. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar dhe me aktgjykim ta anuloj vendimin e AL-së me numër GJI045-0992, të datës 13.03.2015; dhe të detyrohet e paditura që në emër të pagave të pa paguara për periudhën 1991-2004, t’ia kompensoj shumën prej 54,143.46 €.

Pala paditëse bashkë me padinë ka dorëzuar edhe vendimin e atakuar të AL-së, GJI045-0992, të datës 13.03.2015.

Me datën 11.06.2021, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimeve të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tyre me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL-së, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Shtojcën e Ligjit për AKP-në. Paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Po ashtu, ka theksuar se rregull bazike e procedurës civile është se pala paditëse ka detyrimin e parashtrimit të provave (barrën e provave), dhe si ky rregull ky rregull është i përcaktuar në nenin 7 të LPK-së dhe me nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Më tutje, ka theksuar se me datën 29.01.2014, paditësi ka parashtruar një kërkesë kreditore përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 55,405.00 €, në emër të kompensimit të pagave për periudhën nga viti 1991, kur e ka pranuar vendimin për largim nga marrëdhënia e punës në Ndërmarrje. AL i ka dërguar paditësit kërkesë për dëshmi shtesë, ku parashtruesi tre ditë me vonesë ka dërguar një kopje të aktgjykimit me numër, C.nr.102/2003, dhe një kopje të ekspertizës financiare. Mirëpo, përkundër kërkesës specifike pala paditëse nuk ka dorëzuar aktgjykimin e formës së prerë, po ashtu nuk ka ofruar prova që vërtetojnë se palës paditëse i është njohur e drejta në kompensim të të ardhurave personale. Po ashtu, në përgjigje në padi është theksuar se paditësi me padi pohon se në vitin 1991, i është ndërprerë marrëdhënia e punës përmes vendimit, mirëpo ndaj të njëjtit nuk rezulton të ketë ushtruar ankesë pranë organit brenda ndërmarrjes e as pranë Gjykatës së Punës së Bashkuar. Nga kjo rezulton se paditësi nuk ka pasur një marrëdhënie pune në ndërmarrje dhe nuk i takon kompensimi i të ardhurave personale. Me tutje është thirrur në parashkrimin e kërkesës, duke theksuar se pala paditëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të kërkuar kompensimin e të ardhurave personale deri në vitin 2003. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Me datën 02.09.2017, paditësi ka dorëzuar pran kësaj gjykate përgjigje në përgjigjen në padi të të paditurit, ku ndër të tjera ka theksuar: argumenti i palës paditëse se ankesa është dorëzuar jashtë afatit është i pa qëndrueshëm. Po ashtu e ka kundërshtuar pretendimin e palës së paditur e cila ka theksuar se kërkesa kreditore është e parashkruar, duke ri kujtuar se kërkesa e tij është e bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë i cili është bërë formës së prerë me datën 13.11.2003, dhe se me këtë aktgjykim i është miratuar kërkesëpapia për kthim në vendin e punës në ndërmarrje. Një pjesë e këtij aktgjykimi është zbatuar nga ndërmarrja dhe se në atë kohe është kthyer në vendin e punës, ndërsa në lidhje me pagat e pa kompensua ka iniciuar procedurë e cila ka zgjatur me vite të tëra deri në momentin kur ndërmarrja ka hyrë në procedurën e likuidimit. Sipas paditësit, procedura gjyqësore e ka ndërprerë afatin e parashkrimit të kërkesës.

Me datën 28.09.2017, pala e paditur ka paraqitur kundërpërgjigje, ku ndër të tjera ka theksuar: se ankesa është e pa pranueshme ngase është jashtë afatit për dorëzimin e anekses. Edhe në përgjigje ka pretenduar se kërkesa është e parashkruar kjo për faktin se vendimi për largim nga puna është bërë i formës së prerë me datën 12.02.1991 dhe se procedura e parë gjyqësore nga pala paditëse është zhvilluar në vitin 2003, pas 12 viteve nga pranimi i vendimit për largim nga

puna. Në momentin kur paditësi ka parashtruar padinë në Gjykatën Komunale në Kamenicë, kërkesa ka qene e parashkruar. Po ashtu ka theksuar se me aktgjykimin e gjykatës është anuluar vendimi për largim nga puna, mirëpo në asnjë mënyrë nuk i njihet e drejta në kompensimin e te ardhurave personale për periudhën e pretenduar.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate, të datës 09.10.2020, është refuzuar kërkesëpadia si e pa bazuar. Kolegji i Apelit i kësaj gjykate, në procedurë ankimore, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Gjendja faktike e konstatuar

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë te rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”.*

Pala paditëse ka dorëzuar provat si në vijim: Kopjen e librezës së punës; ekspertizën gjyqësore financiare të kryer në Gjykatën Komunale në Kamenicë; aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë me numër C.nr.102/2003; padinë e datës 01.02.2005, të parashtruar pranë Gjykatës Komunale në Kamenicë; aktgjykimin me numër C.nr.83/2005, të Gjykatës Komunale në Kamenicë; aktvendimin me numër AC.nr.11/06, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; aktgjykimin me numër C.nr.78/2006, të Gjykatës Komunale në Kamenicë; aktvendimin me numër Ac.nr.279/2007, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; aktgjykimin me numër C.nr.105/2007, të Gjykatës Komunale në Kamenicë; aktvendimin me numër AC.nr.183/2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; dhe aktvendimin me numër C.nr.203/2009, të Gjykatës Komunale në Kamenicë.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë analizën e fakteve dhe provave të prezantuara nga palët në procedurë, konform rregullave që rrjedhin nga neni 8.1 i LPK-së dhe dispozitat tjera ligjore të ndërlidhura.

Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe analiza e provave të prezantuara, gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet vendimtare të prezantuara nga pala paditëse, janë jo kontestuese, madje të mbështetura edhe në provat që ka prezantuar, si në vijim:

- Pala paditëse ka qene në marrëdhënie punë në Ndërmarrje, e pastaj me vendimin me numër 107, të datës 12.02.1991, është larguar nga puna. Kundër largimit nga puna pala paditëse ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale në Kamenicë, e cila me aktgjykimin, C.nr. 102/2003, e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, e ka anuluar vendimin e NSH-së për largim nga puna, si dhe i ka vënë detyrimin NSH-së që paditësin ta kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.
- Me datën 20.12.2004, paditësi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale në Kamenicë, kundër Ndërmarrjes si palë e paditur, përmes të cilës ka kërkuar kompensimin

- e te ardhurave personale për periudhën 01.09.1990-31.12.2004, në shumën prej 55,405.00 €. Gjykata Komunale në Kamenicë me aktgjykimin me numër C.nr.83/2005, kërkesëpadinë e parashtruar nga pala paditëse e ka refuzuar si të pa bazuar. Kundër këtij aktgjykimi pala paditëse ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan e cila me aktvendimin me numër AC.nr.11/06, e ka aprovuar ankesën e parashtruar nga paditësi e ka prishur aktgjykimin C.nr.83/2005, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.
- Gjykata Komunale në Kamenicë me aktgjykimin C.nr.78/2006, duke vendosur në rigjykim e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruar nga pala paditëse dhe e ka detyruar palën e paditur (Ndërmarrjen) që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 6,045.74 €, në emër të kompensimit të te ardhurave personale për periudhën 12.02.1992-01.07.1999. Ndërsa për periudhën 1999-2004, kërkesëpadinë e ka refuzuar si të pa bazuar. Kundër këtij aktgjykimi pala paditëse ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan e cila me aktvendimin me numër AC.nr.279/07, e ka aprovuar ankesën e parashtruar nga pala paditëse e ka anuluar aktgjykimin me numër C.nr.78/2006, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.
 - Gjykata Komunale në Kamenicë me aktgjykimin C.nr.105/2007, duke vendosur në rigjykim, ka nxjerrë aktgjykim, ku me paragrafin I të tij, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruar nga pala paditëse dhe e ka detyruar palën e paditur (Ndërmarrjen) që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 6,045.74 €, në emër të kompensimit të te ardhurave personale për periudhën 12.02.1991-01.07.1999. Ndërsa në paragrafin II të dispozitivit të aktgjykimit, e ka refuzuar kërkesëpadinë për kompensimin e pagave për periudhën 1999-2004. Kundër atij aktgjykimi paditësi përsëri ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan, e cila ka marrë aktvendimin AC.nr.183/09, me të cilin e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë në përkitazi me paragrafët II dhe III të dispozitivit, ndërsa lidhur me paragrafin I të dispozitivit, ku palës paditëse i është aprovuar shuma prej 6,045.74 €, në emër të kompensimit të te ardhurave personale për periudhën 12.02.1991-01.07.1999, ka ngelur i pa shqyrtuar, që do të thotë se në atë pikë, aktgjykimi është bërë i formës së prerë.
 - Gjykata Komunale në Kamenicë duke vendosur në procedurën e rigjykimit për pikën II dhe III të aktgjykimit, me aktvendimin C.nr.203/2009, të datës 18.01.2012, është shpallur jokompetente për të vendosur në këtë çështje juridike dhe lëndën ia ka referuar Dhomës së Posaçme.
 - Pasi Ndërmarrja ka hyrë në likuidim, respektivisht më 29.01.2014, pala paditëse ka parashtruar kërkesë kreditore pranë AL-së, duke kërkuar pagesën e shumës prej 55,405.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara nga Ndërmarrja. AL e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin me numër GJI045-0882, të datës 13.03.2015, e ka refuzuar atë.
 - Siç është shtjelluar më sipër, paditësi posedon me dy aktgjykime, dhe atë: 1. Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C.nr. 102/2003, me të cilin është miratuar

kërkesëpadia dhe është anuluar vendimi i Ndërmarrjes për largim nga puna dhe se pala e paditur është detyruar që paditësin ta kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës; dhe 2. Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Kamenicë, C.nr.105/2007, me të cilin është miratuar pjesërisht kërkesëpadia dhe është detyruar Ndërmarrja që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 6,045.74 €, në emër të kompensimit të të ardhurave personale për periudhën 12.02.1991-01.07.1999. Ky aktgjykim është bërë i formës së prerë në këtë pjesë, ndërsa lidhur me pjesën tjetër të kërkesëpadiës, rasti është kthyer në rigjykim, dhe pasi lënda është bartur në kompetencën e Dhomës së Posaçme, rasti ka marrë numrin C-II-13-0091-C0001.

- Dhoma e Posaçme, me aktvendimin C-II-13-0091-C0001, të datës 27.06.2017, e ka pezulluar procedurën kontestimore, për shkak se Ndërmarrja ka hyrë në procesin e likuidimit.

Gjykata potencon më tutje se është parim i përgjithshëm në procedurën gjyqësore kontestimore, se faktet jo kontestuese nuk është e nevojshme që të provohen nga gjykata. Me nenin 321.2 të LPK-së, është përcaktuar se *“Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”*. Gjykata vlerëson se faktet e renditura më sipër, janë vendimtare (relevante) dhe të mjaftueshme për të pasur një pasqyrë të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, nga kjo çështje kontestimore. Po ashtu, gjykata vlerëson se faktet e sipërmendura të cilat janë jo kontestuese në mes të palëve, po ashtu janë në përputhje të plotë me të dhënat nga provat e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- *Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.*
- *Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.*

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritor pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 398 të LPK-së (aktgjykimi miratues) dhe me nenin 399 të LPK-së (aktgjykimi refuzues), ku është përcaktuar si në vijim:

Neni 398: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Neni 399: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi. 399.2 Kërkesëpadi është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadi qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.*

Siç është shtjelluar më sipër, në këtë çështje kontestimore, faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese. Sikurse vendimi i AL-së i atakuar me padi, ashtu edhe përgjigja në padi e paraqitur nga AKP-ja dhe parashtrimet e tjera të mëvonshme, nuk i kontestojnë faktet dhe rrethanat në të cilat thirret pala paditëse në kërkesën kreditore dhe me kërkesëpadi. Por, refuzimi i kërkesës është mbështetur në këto argumente: Kërkesa kreditore është parashkruar nga se vendimi për largim nga puna është i vitit 1991 dhe se procedura e parë gjyqësore nga pala paditëse është zhvilluar në vitin 2003, respektivisht pas 12 viteve nga pranimi i vendimit për largim nga puna. Pastaj, me aktgjykim është anuluar vendimi për largim nga puna, mirëpo në asnjë mënyrë nuk i është njohur paditësit e drejta në kompensimin e të ardhurave personale për periudhën e pretenduar.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme. Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e shqyrtuara, rezulton se kontesti në mes të palëve në procedurë është i natyrës së pastër ligjore, ku pala e paditur ka pretenduar se kërkesa kreditore për pagat e pretenduara është parashkruar dhe se nuk ka mbështetje në vendime gjyqësore të plotëfuqishme për paga por vetëm për kthimin në punë. Ndërsa pala paditëse ka pretenduar se i takon e drejta në pagat i specifikuara me padi.

Pas vlerësimeve të bëra në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa për pagat e papaguara që i takojnë periudhës 1991-1999, është e bazuar sepse mbështetet në aktgjykimin C.nr.205/2007, të datës 10.02.2009, i cili aktgjykim është bërë i formës së prerë përkitazi me pjesën e miratuar, përmes aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac.nr.183/09, të datës 08.10.2009. Siç shihet, kompensimi i pagave që i përkasin kësaj periudhe, tashmë është çështje e gjykuar dhe atë në shumën prej 6,045.74 €, sa janë njohur edhe paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. E paditura nuk e ka vënë në dyshim vlefshmërinë e aktgjykimit të lartpërmendur.

Gjykata e ka shqyrtuar pretendimin e të paditurës se është parashkruar e drejta për të kërkuar pagat e kësaj periudhe, konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Gjykata potencon se në këtë rast nuk zbatohet dispozita në fjalë e as dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen e ngjashme dhe që kanë vendosur afatet prej tri vitesh për kërkesat periodike (LMD i vitit 1978 dhe LMD i vitit 2012). Kjo nga arsyeja se kemi të bëjmë me kërkesë të njohur me aktgjykim të formës së prerë, për të cilën me ligj është vendosur afat specifik me kohëzgjatje më të madhe kohore se tri vite. Kështu, me nenin 379 të LMD-së së vjetër (të vitit 1978) është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet dhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashkrimi”*. Pastaj, me nenin 361 të LMD-së së vitit 2012 është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*. Meqenëse aktgjykimi i formës së prerë është i datës 08.10.2009, ndërsa kërkesa kreditore është parashtruar pran AL-së më 29.01.2014, rezulton se nuk ka kaluar afati dhjetë (10) vjeçar e rrjedhimisht edhe nuk është parashkruar kërkesa kreditore.

Gjykata i ka shqyrtuar pretendimet e të paditurës se kërkesa kreditore është parashkruar nga se vendimi për largim nga puna është i vitit 1991 dhe se procedura e parë gjyqësore nga pala paditëse është zhvilluar në vitin 2003, respektivisht pas 12 viteve nga pranimi i vendimit për largim nga puna. Mirëpo, këto pretendime nuk kanë ndonjë peshë vendimtare në relacion me faktin se kompensimi i shumës prej 6,045.74 €, në emër të pagave të periudhës 1991-1999, është çështje e gjykuar dhe se kërkesa për ekzekutimin e atij aktgjykimi në procedurë likuidimi, e vitit 2014, nuk ishte kërkesë e parashkruar, pasi nuk kishte skaduar afati 10 vjeçar i parashkrimit.

Gjykata ka parasysh se është e mundur që paditësi nuk e ka prezantuar aktgjykimin në fjalë pran AL-së bashkë me kërkesën kreditore, e rrjedhimisht AL nuk e ka zbatuar afatin 10 vjeçar të parashkrimit, por afatin 3 vjeçar, gjë që ka rezultuar edhe me refuzim të kërkesës kreditore. Sigurisht se edhe pretendimi tjetër i AL-së se paditësit nuk i është njohur e drejta në kompensimin e të ardhurave personale por vetëm e drejta e kthimit në punë, ka rezultuar nga mungesa e informacionit për ekzistencën e aktgjykimit C.nr.205/2007. Sidoqoftë, gjatë procedurës gjyqësore pran kësaj gjykate, pala e paditur e ka pasur në dispozicion aktgjykimin dhe ka pasur mundësinë të shpalos qëndrimet e saj.

Po ashtu, objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte edhe kërkesa që i përket periudhës 1999-2004. Me Shtojcën e Ligjit për AKP-në, neni 40 (Prioritetet e kërkesave dhe interesave), kërkesat për paga janë kategorizuar në grupin e kërkesave të pasiguruara, ndërsa kërkesat për tri paga janë kategorizuar si kërkesa preferenciale. Mirëpo nga provat e shqyrtuara nuk është provuar paditësi nuk ishte i punësuar në Ndërmarrje gjatë periudhës 02.07.1999-2004, e as nuk ka kryer shërbime në Ndërmarrje. Gjykata sqaron më tutje se paga është e drejtë e punëtorit që ka të themeluar marrëdhënien e punës, dhe është rezultat e procesit të punës dhe i krijimit apo zhvillimit të fondit të ndërmarrjes, ku pastaj një pjesë e atij fondi shpërndahet për pagat e punëtorëve të përfshirë në procesin e punës. Me që paditësi nuk ka qenë punëtor i Ndërmarrjes gjatë periudhës kontestuese dhe nuk ka qenë i angazhuar në punë, nuk janë prodhuar as të drejta dhe detyrime reciproke në mes atij dhe Ndërmarrjes, në aspektin e pagave. Është fakt se me aktgjykimin C.nr.102/2003, i është vënë për obligim Ndërmarrjes që paditësin ta kthej në vendin e punës, mirëpo paditësi nuk ka ofruar prova që gjatë periudhës 02.07.1999 - 2004, të jetë ekzekutuar aktgjykimi, qoftë në mënyrë vullnetare apo përmes ndonjë procedure përmbarimore. Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në dispozitat ligjore të cituara, gjykata ka vendosur si në paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e vonesës është i bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar se *“Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë”*. Në këtë çështje kontestimore, pala paditëse ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar ato. Gjykata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur paditësit të drejtën

në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi i njëjti e ka fituar gjykimin pjesërisht, në shumat si në vijim: 104 €, në emër të parashtrimit të kërkesës kreditore €; 156 € në emër të përpilimit të padisë; 156 € në emër të përpilimit të përgjigjes në përgjigje në padi; 156 € në emër të përpilimit të ankesës kundër aktgjykimit; dhe 62.00 € në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi dhe për ankesë, në shumën e përgjithshme prej 634.00 €.

Udhëzimi juridik

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Miftari